

VIZE PER PUNE ME KONTRATE

Viza për Punë me Kontratë i lejon hyrjen në Itali për një kohë të kufizuar ose të përhershme atij personi i cili ka një Autorizim Pune (Nulla Osta) të lëshuar nga Sporteli Unik për Emigracionin (Sportello Unico per l'Immigrazione).

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Punë me Kontratë duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

1) Pasaportë të vlefshme të paktën deri në skadimin e afatit të vizës së kërkuar;

2) Autorizimi personal për punë (Nulla Osta) i lëshuar në datë jo më të hershme se 6 muaj nga:

Sporteli Unik për Emigracionin (Sportello Unico per l'Immigrazione).

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE